



Pranuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	02.02.2024	9	viti god. year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOC	679/2024		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1546/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1546/2023, të datës 20.12.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ më adresë \_\_\_\_\_ në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1546/2023, të datës 20.12.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ (me tej referuar vetëm ankuesi), me datë 20.12.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1546/2023, kundër konkursit të shpallur nga Fondi i Kosovës për Eficiencës të Energjisë, për pozitën Drejtor i Sektorit të Operacioneve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me çështjen, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ *sepse:*

Kolegji bazuar në shkresat e parashtruara nga ankuesi ka gjetur se ankuesi ka konkurruar në Konkursin me numër të referencës 11/2023/FKKEE për pozitën e punës Drejtor i Sektorit të Operacioneve, i shpallur nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, me afatat të aplikimit

16.11.2023 deri me 30.11.2023, mirëpo qe i njëjti ishte diskualifikuar për vazhdim në fazat e mëtejme për shkak së i njëjti nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit.

Kolegji i Këshillit në kuptim të kompetencës për shqyrtim dhe vendosje lidhur me këtë çështje juridiko administrative ka analizuar Ligjin Nr.06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, me theks të veçantë:

- nenin 1 paragrafi 1: *Ky ligj përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të caqeve të eficiencës së energjisë dhe arritjen e këtyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për eficiencë të energjisë, zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të eficiencës së energjisë...*
- nenin 24 *"Fondi i Kosovës për Eficiencës së Energjisë themelohet me këtë ligj si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, për të mundësuar që Qeveria e Kosovës të arrijë objektivat politike të saj për eficiencën e energjisë përmes promovimit, mbështetjes dhe ose zbatimit të masave të eficiencës së energjisë si dhe tërheqjes dhe menaxhimit të burimeve financiare për të financuar dhe zbatuar projektet e investimeve në fushën e eficiencës së energjisë në mënyrë të qëndrueshme*
- nenin 25 paragrafi 4: *FKEE ka autonomi të plotë operationale dhe administrative dhe funksionon jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës dhe nuk konsiderohet si organizatë buxhetore në kuptim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.*

Po ashtu Kolegji iu referuar edhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Punësimin dhe Shpërblimin e Personelit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, gjegjësisht:

- Nenin 18 paragrafi 1: *"Aktivitetet e FKEE-së do të kryhen brenda Njësive Organizative të Brendshme (NjOB) që përbëhen nga njësitë e dy llojeve: (i) shërbimet, dhe (ii) sektorët.*
- Neni 22 paragrafi 1 dhe 14 : 1. *Procedurat e punësimit dhe kontratat e punës 1. Në pajtim me Ligjin për Punë (Nr. 93/L-212) të Kosovës, FKEE-ja, si punëdhënës në sektorin publik ("Punëdhënësi"), është i obliguar të shpallë konkursin publik çdo herë kur punëson një punonjës dhe krijon një marrëdhënie pune....14. Kandidatët e pa suksesshëm mund të parashtrajnë ankesë ndaj vendimit përfundimtar brenda tetë (8) ditëve në komisionin e ankesave i cili përbëhet nga tre (3) anëtarë. Komisioni do të nxjerr vendim lidhur me ankesën brenda 15 ditëve. Vendimi do tu komunikohet brenda 3 ditëve dhe do të përmbajë edhe udhëzimin për të drejtën e ankimit ndaj vendimit në Inspektoratin e Punës brenda tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendim.."*

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, rrjedhë së të punësuarit në Fondin e Kosovës për Eficiencës së Energjisë, nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, kështu që duke qenë objekti i ankesës, ka të bëjë me kontestimin e procedurës së pranimit si nëpunës në këtë subjekt, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1546/2023, të datës 20.12.2023, të parashtruar nga ankuesi

Duke marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, e në mbështetje nenit 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1546/2023

Sabile Avdyli

Profesmbajtese



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë.
- Arkivit të KPMSHCK-së.

